



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:213024

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05468771

PPP.nr.213/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rr "...", nr..., kundër debitorit A.A. nga fsh ..., Komuna e Shtimes, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit A.A., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.142/2022, i datës 20.09.2022, i lëshuar nga përbaruesi privat E.Sh.L. nga Prishtina dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.142/2022, i datës 20.09.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.142/2022, të datës 20.09.2022, përbaruesi privat E.Sh.L., e ka caktuar përbarimin e propozuar nga kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, kundër debitorit A.A., për pagesën e gjobës në shumë prej 5,258.48 euro dhe shpenzimet e përbarimit, në bazë të aktvendimit Nr...., të datës 11.09.2020, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përbaruesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin për përmbarim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se debitori në mbështetje të udhëzimit juridik dhe ligjit kundër vendimeve të organeve administrative të shkallës së parë dhe të dytë ka paraqitur padi për hapjen e konfliktit administrativ pasi që këto vendime janë marrë në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, rrjedhimisht në mënyrë të gabuar i kanë shqiptuar gjobën që i vihet në barre, Gjykata këto pretendime të debitorit i konsideron të pabazuara sepse në bazë të nenit 21, të Ligjit për Konfliktet Administrative, padia për hapjen e konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ, përveç kur me ligj është parashikuar ndryshe.

Përveç tjerash, Gjykata konstaton se dokumenti përmbarimor në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarim, siç është aktvendimi Nr...., i datës 11.09.2020, është i përshtatshëm për përmbarim dhe në pajtim të plotë me nenin 27, par 1, të LPP-së, sepse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Po ashtu, Gjykata vlerëson se aktvendimi i cekur më lart është i paisur edhe me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmërisë, respektivisht në bazë të nenit 36, par 1, të LPP-së, përkatësisht është i formës së prerë me datën 19.01.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 04.02.2022.

Gjithashtu, Gjykata konstatoj se propozimi për përmbarim i kreditorit është në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 38, par 1, të LPP-së, respektivisht propozimi për përmbarim i kreditorit siç shihet e përmban kërkesën për përmbarim, dokumentin e besueshëm, siç është ekstrakti i verifikuar nga librat afariste në origjinal, kërkesin e përmbarimit dhe të dhënat e debitorit, duke e përfshirë edhe numrin personal të letërnjoftimit të debitorit, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.

Si përfundim, duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim dhe thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, Gjykata konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbarim P.nr.142/2022, i datës 20.09.2022, të mbetet në fuqi.

Andaj, Gjykata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.213/22, më datë 19.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.